

**Kush po e bllokon
formimin e
institucioneve?!** ■ FAQE 7

Behxhet
Sh. SHALA -
BAJGORA



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

ALBULENA HAXHIU DËSHTON PËRSËRI TË ZGJIDHET KRYETARE E KUVENDIT,
SEANCA SHTYHET PËR TË PREMTEN ■ FAQE 4

VAZHDON BLLOKADA PËR FORMIMIN E INSTITUCIONEVE TË REJA



Edhe në përpjekjen e pestë
deputetët kanë dështuar ta
konstitujnë Kuvendin e
Kosovës. Kandidatja e
Lëvizjes Vetëvendosje,
partisë fituese të
zgjedhjeve, Albulena


Haxhiu, dështoi të zgjidhej
kryetare e Kuvendit.
Opozita e kundërshtoi
përsëri emërimin e Haxhiut.
Kryesuesi i seancës, Avni
Dehari, njoftoi se seanca e
ndërprerë do të vazhdojë të

premtën në orën 11:00. E
njohësit e proceseve
politike kanë thënë se
historikisht zgjedhja e
kryetarit të Kuvendit ka
qenë gjithmonë rezultat i
marrëveshjeve politike

**OSMANI: ÇDO
MARRËVESHJE
PAQEJE NUK DUHET
T'I INKURAJOJË
AMBICIET
IMPERIALISTE
TË RUSISË** ■ F. 6



**BE-ja PROPOZON
T'I KTHEJË MË
SHPEJT NË KOSOVË:
ÇFARË THONË
TË DHËNAT PËR
AZILKËRKUESIT?** ■ F. 3



AKTUALE



**TËRMET I FUQISHËM AFËR BRIGJEVE
TË STAMBOLLIT** ■ F. 2

**KOSOVA MBYLL SËRISH
INSTITUCIONE TË SERBISË** ■ F. 7

**BISLIMI: TURQIA, NJË
NGA INVESTITORET DHE
PARTNERET TREGTARE
MË TË MËDHA QË KA KOSOVA** ■ F. 8

EKONOMI



**DELEGACIONI I BQK-SË ZHVILLON
TAKIME TË RËNDËSISHME NË
SELINË E FMN-së** ■ F. 8

**RRITJA E ÇMIMEVE NË KOSOVË
NË MUJIN MARS: KAFEJA,
VEZËT, QUMËSHI DHE PERIMET,
MË TË SHITRENJTA** ■ F. 8

SPORT



**MURIOI MUND TË LARGOHET NGA
MALLORCA NË VERË** ■ F. 10

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@ml.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVIÇE
044/256-051
044/367-061
028/532-617

Kolegji BIZNESI
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SHA
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Tërmet i fuqishëm afër brigjeve të Stambollit

STAMBOLL, 23 PRILL - Një tërmet prej 6.2 ballësh ka goditur Detin Marmara, afër Stambollit, teksa dridhjet e tokës janë ndierë në mbarë qytetin. Ende nuk ka raportime për të lënduar apo dëme, por zyrtarët nga agjencia për menaxhimin e fatkeqësive në Turqi, AFAD, thanë se tërmeti i fuqishëm u pasua me tetë tërmete të tjera. “Një tërmet prej 6.2 ballësh ka goditur në Silivri, Deti i Marmarasë në Stamboll”, shkroi në “X” ministri i Brendshëm, Ali Yerlikaya, i cili shtoi se dridhjet e tokës u ndien edhe në provincat përreth. Tërmeti i parë ndodhi në orën 12:49, sipas kohës lokale, me epiqendrën në thellësi prej 6.92 kilometrash nën det. Epiqendra e

tërmetit gjendet në jug të qytetit të Stambollit, tha AFAD. Tërmeti u pasua nga tetë pasgoditje me shkallë të ndryshme, duke u nisur nga 3.5 deri në 5.9 shkallë të Rihterit. Si pasojë e dridhjeve të tokës, rrugët e Stambollit – qytetit më të madh në Turqi – u mbushën me njerëz që dolën nga ndërtesat. Pamjet e publikuara nga agjencia shtetërore e lajmeve, “Anadolu”, shfaqën minaren e një xhamie në Stamboll duke u lëkundur gjatë tërmetit të parë. Por, nuk ka raportime se ndonjë ndërtesë është shembur në Stambollin e banuar me 16 milionë banorë. Pas tërmetit, presidenti turk Recep Tayyip Erdogan tha se “po vëzhgoj nga afër zhvillimet”.



Tërmeti i fundit që goditi Stambollin ishte në nëntorin e kaluar, kur dridhjet e tokës shkaktuan panik në mesin e banorëve, por nuk u raportua për dëme apo viktima. Sizmologët turq dhe të huaj pajtohen se Stambolli ka shumë gjasa që të goditet nga tërmete të fuqishme në dekadat e ardhshme për shkak se gjendet më pak se 20 kilometra nga pllaka tektonike e Anadollisë së Veriut. Afër 20 000 persona u vranë, pasi më 1999 brenda tre muaj pjesa veriperëndimore e Turqisë - përfshirë disa pjesë të Stambollit - u godit nga dy tërmete masive. Gjatë këtyre tërmeteve pjesa lindore e pllakës tektonike të Anadollisë së Veriut u ça.

Gjykata urdhëron ndaljen e shuarjes së Zërit të Amerikës

UASHINGTON, 23 PRILL - Një gjykatës i një gjykate federale në Uashington ka urdhëruar administratën e presidentit Donald Trump që t'i ndalë përpjekjet që synojnë shuarjen e Zërit të Amerikës (VOA), që u mbyll muajin e kaluar. VOA i ka cilësuar të paligjshme lëvizjet e administratës për mbylljen e transmetuesit. Gjykatësi Royce Lamberth vendosi më 23 prill lëshimin e një urdhri paraprak që thotë se zyrtarët duhet “t'i marrin të gjithë hapat e nevojshme” për t'i rikthyer punonjësit dhe bashkëpunëtorët në pozitat e tyre në VOA dhe që të rikthehen fondet, e miratuara nga Kongresi, për dy transmetuesit e tjerë të financuar nga Qeveria amerikane



- Radio Azia e Lirë dhe Rrjeti i Transmetuesit të Lindjes së Mesme - dhe t'i rifillojnë transmetimet në radio, televizion dhe internet.

Lamberth, i cili po trajton gjashtë padi nga punonjësit dhe bashkëpunëtorët e prekur nga mbyllja e urdhëruar nga Agjencia e ShBA-së për Media Globale

(USAGM), që mbikëqyr transmetuesit federalë, urdhëroi mediet që të paraqesin raporte mujore mbi ecurinë, për të treguar nëse USAGM po zbaton urdhrin për të lejuar ata të “ofrojnë lajme që vazhdimisht janë të besueshme, të sakta, objektive dhe gjithëpërfshirëse”. USAGM nuk ka reaguar publikisht për vendimin e gjykatës. Muajin e kaluar VOA ngrii padi ndaj administratës Trump, pas administratës, përmes një urdhri ekzekutiv, e udhëzoi USAGM dhe gjashtë agjenci të tjera federale që të ulnin në minimumin e kërkuar nga ligji punën e tyre. Më pas USAGM dërgoi në pushim më shumë se 1.000 punonjës dhe ndërpreu kontratat

me rreth 600 bashkëpunëtorë, duke e detyruar VOA, që për herë të parë që nga themelimi më 1942, të ndalë transmetimin. USAGM kishte argumentuar se për këtë çështje nuk ka “një vendim përfundimtar” lidhur me të ardhmen e VOA dhe se paditë duhet të trajtohen si “mosmarrëveshje të punësimit” me punonjësit e larguar nga puna. Radio Evropa e Lirë, po ashtu, ka ngritur padi ndaj USAGM për të “shmangur dëmin e pariparueshëm” ndaj transmetuesit për shkak të mbajtjes pezull të grantit - të miratuar nga Kongresi - si pjesë e përpjekjeve të USAGM-it për të ndërprerë financimin e REL-it. Rasti i Radios Evropa e Lirë ende po trajtohet nga gjykata.

Shtyhen bisedimet për paqe në Ukrainë mes ministrave të Jashtëm në Londër

LONDËR, 23 PRILL - Bisedimet e nivelit të lartë për Ukrainën, të cilat ishin paraparë të zhvilloheshin në Londër, janë shtyrë të mërkurën, njoftoi Ministria e Jashtme e Britanisë, pasi disa diplomatë të lartë u tërhoqën në çastet e fundit. Njoftimi erdhi pak orë para nisjes së takimeve të 23 prillit, të cilat parashihej të përfshinin ministrin e Jashtëm të Ukrainës. “Konfirmojmë se Bisedimet për Paqe në Ukrainë sot, me ministrat e Jashtëm, janë shtyrë”, i ka thënë Qeveria britanike Radios Evropa e Lirë, duke shtuar se “bisedimet e nivelit zyrtar do të vazhdojnë, por ato do të jenë të mbyllura për mediat”. Bisedimet, që kishin për synim të gjenin rrugën drejt përfundimit të luftës 38-muajshe të Rusisë në Ukrainë, u përballën



me sfida edhe më herët, kur diplomatë të lartë, përfshirë sekretarin amerikan të Shtetit, Marco Rubio, anuluan pjesëmarrjen dhe zbehën

përpjekjet e vazhdueshme për paqe. Sekretari i Jashtëm britanik, David Lammy, po ashtu zgjodhi të mos merrte pjesë në takime, raportoi

Sky News më herët, ndonëse kjo nuk është konfirmuar. Delegacioni i Ukrainës, përfshirë këshilltarin kryesor të presidentit Volodymyr Zelensky, udhëtoi në Londër, me gjithë shtyrjen e bisedimeve. “Pavarësisht çdo gjëje, ne do të punojmë për paqe”, shkroi Andriy Yermak në Telegram. Javën e kaluar Rubio dhe zyrtarë të tjerë të lartë ukrainas dhe evropianë u takuan në Paris për bisedime që prodhuan atë që shumë e panë si përparim të vogël drejt përfundimit të luftës. Por, Rubio më vonë sinjalizoi mosdurimin e ShBA-së me gjendjen e bisedimeve, dhe sugjeroi se Shtetet e Bashkuara mund të tërhiqen tërësisht nga përfshirja në negociata. Gjatë fundjavës media amerikane

si “Wall Street Journal”, “Bloomberg” dhe CNN raportuan se negociatorët amerikanë i kanë paraqitur Ukrainës një listë me lëshime të mundshme. Mes tyre thuhet se është edhe njohja e mundshme amerikane e aneksimit rus të Gadishullit të Krimesë më 2014, dhe një refuzim definitiv i aspiratave të Ukrainës për anëtarësim në Organizatën e Traktatit të Atlantikut Verior (NATO). Që të dyja temat konsiderohen të papranueshme për presidentin ukrainas Zelensky dhe qeverinë e tij. “Ukraina nuk do ta njohë okupimin e Krimesë”, u ka thënë ai gazetarëve në Kiev më 22 prill. “Është territor yni, territor i popullit të Ukrainës, s’ka asgjë për t’u diskutuar këtu”, është shprehur Zelensky.

BE-JA PROPOZON T'I KTHEJË MË SHPEJT NË KOSOVË: ÇFARË THONË TË DHËNAT PËR AZILKËRKUESIT?

PRISHTINË, 23 PRILL - Që prej liberalizimit të vizave më 1 janar të vitit të kaluar, numri i azilkërkuesve nga Kosova në Bashkimin Evropian është rritur ndjeshëm. Tani një propozim i Komisionit Evropian mund të bëjë që ata të detyrohen të kthehen në Kosovë, pasi që Komisioni Evropian ka propozuar që për azilkërkuesit nga Kosova dhe gjashtë vende të tjera të përshpejtohen procedurat për kthimin e tyre në vendlindje, sepse i cilëson ato si vende të sigurta.

Tani u mbetet Parlamentit dhe Këshillit Evropian ta aprovojnë këtë propozim ose jo për shtatë vendet - Kosovën, Bangladeshin, Kolumbinë, Marokun, Tunizinë, Egjiptin dhe Indinë - nga të cilat vitin e kaluar aplikuan gjithsej 200 mijë njerëz për azil. Pikërisht vitin e kaluar, numri i azilkërkuesve nga Kosova u rrit dukshëm në krahasim me vitet paraprake.

Çfarë ndikoi në këtë rritje?

Nga 1 janari i vitit 2024, pas shumë viteve pritje, kosovarët kanë mundur të udhëtojnë nëpër 29 vendet anëtarë të zonës Schengen, kryesisht shtete anëtarë të BE-së, pa pasur nevojë për vizë.

Ky liberalizim i vizave mundëson udhëtime pa viza vetëm deri në 90 ditë - brenda gjashtë muajsh - në cilindo nga



29 shtetet anëtare të zonës Schengen.

Parimisht, udhëtimet pa viza duhet të shërbejnë për vizita turistike, çështje familjare ose të ngjashme, dhe assesit për punë apo përfitime të tjera. Por, qysh para liberalizimit, organizata të shumta kishin paralajmëruar se liberalizimi i vizave mund të përkeqësojë trendin e migrimit nga Kosova. Dhe, të dhënat e zyrës së statistikave të BE-së (Eurostat) tregojnë se pikërisht një gjë e tillë ka ndodhur.

Edhe pse jo në nivelet për të cilat kishin paralajmëruar shumë organizata joqeveritare, trendi i rritjes së kërkesave të azilkërkuesve po vazhdon edhe këtë vit.

Njëjtë si në vitet paraprake,

Franca mbetet destinacioni kryesor i kosovarëve që kërkojnë azil në vendet e Bashkimit Evropian, ndjekur pas nga Gjermania.

Edhe Gjermaninë e kanë synuar shumë kosovarë në vitet e fundit për shkak të procedurave të lehtësuara për punësim. Por, pasi procedurat për marrjen e vizës së punës janë lehtësuar, në kërkesat për azil nuk përfshihen këta persona dhe numri është më i vogël.

Në mesin e azilkërkuesve nga Kosova në BE, më së shumti ka të rinj nën moshën 18-vjeçare dhe burra. Megjithatë, në vitet e fundit, dallimi në numrin e azilkërkuesve gra dhe burra është zvogëluar.

Pas liberalizimit të vizave, është

rritur edhe numri i kosovarëve që detyrohen të kthehen në Kosovë, si pjesë e marrëveshjeve për ripranimin e qytetarëve që u refuzohen kërkesat për azil apo kapen duke qëndruar ilegalisht. Vetëm në tremujorin e parë të këtij viti janë kthyer gati sa gjysma e të gjithë të ripranuarve gjatë vitit 2023, pra para liberalizimit. Shumica e tyre kthehen nga vende të Bashkimit Evropian.

Cilat mund të jenë pasojat?

Përveç përfshirjes në listën e vendeve ku BE-ja synon t'i kthejë në procedurë të përshpejtuar azilkërkuesit, trendi i aplikimeve më të

mëdha rrezikon edhe marrëveshjen për liberalizimin e vizave.

Bashkimi Evropian ka në dorë të ashtuquajturin Mekanizëm të pezullimit të vizave. Me këtë mekanizëm, një vendi joanëtar të BE-së, si Kosova, mund t'i pezullohet përkohësisht përjashtimi nga vizat, nëse bën keqpërdorime.

Janë katër skenarë ku Mekanizmi i pezullimit të vizave do të aktivizohet: Në rast të rritjes së konsiderueshme - mbi 50% - të migrimit të parregullt. Në rast të rritjes së konsiderueshme - mbi 50% - të kërkesave për azil me shkallë të ulët pranimi, rreth 3-4%. Në rast të rënies së bashkëpunimit për riatdhesimin e shtetasve që përjashtohen nga BE-ja, si rezultat i qëndrimit të parregullt. Në rast të rrezikut të shtuar për sigurinë e shteteve anëtare të BE-së, veçanërisht për vepra të rënda penale.

Deri më tani BE-ja nuk ka shprehur shqetësim për rritje të migrimit apo kërkesave për azil nga Kosova, as organizatat që përfaqësojnë bizneset nga Kosova nuk kanë shprehur shqetësim se punëtorët po ikin në mënyrë masive.

Megjithatë, këtë vit BE-ja është duke e shqyrtuar mundësinë që ky mekanizëm të ashpërsohet në atë mënyrë që të jetë më e lehtë për ta kthyer regjimin e vizave për 61 vende, ku përfshihet edhe Kosova dhe vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor.

NJË MUAJ PARABURGIM PËR TË DYSHUARIT PËR VRASJEN E POLICIT LIKA

PRISHTINË, 23 PRILL - Gjykata Themelore e Ferizajt e ka aprovuar kërkesën e Prokurorisë për të caktuar një muaj paraburgim për gjashtë të dyshuarit e arrestuar një ditë më parë në lidhje me vrasjen e rreshterit të Policisë së Kosovës, Muhamed Lika. Të dyshuarit, të cilët u identifikuan nga prokuroria vetëm me inicialet H. B., R. M., V. Ç., E. L., Sh. K., dhe D. G., vijnë nga Kaçaniku. Ata akuzohen për vrasje të rëndë.

Muhamed Lika u vra natën e 1 prillit në shkallët e ndërtesës ku jeton në Kaçanik derisa po kthehej në banesë nga puna. Në vendimin e Gjykatës Themelore thuhet se ekziston dyshim i bazuar se "të pandehurit, duke vepruar në bashkëkryerje, me dashje dhe përgatitje paraprake, kanë planifikuar për ta privuar nga jeta tani të ndjerin - zyrtarin e policisë".

Menjëherë pas përfundimit të

seancës në Gjykatën Themelore të Ferizajt për caktimin e masës, dy nga avokatët e të dyshuarve, thanë se klientët e tyre - R. M. dhe D. G. - mohojnë të kenë qenë të përfshirë në këtë vrasje.

Avokati i R. M., Musa Konxheli, tha se "ne konsiderojmë se s'ka këtu ndonjë grup apo organizim për këtë vrasje". Konxheli tha se, gjatë kohës së vrasjes, klienti i tij ka qenë me të fejuarën e vet. Avokatja e D. G., Fehmiye Gashi-Bytyqi, tha se klienti i saj akuzohet se ka strehuar në shtëpinë e tij vrasësin e dyshuar të policit Lika, por shtoi se ai pretendon që nuk ka qenë në dijeni për krimin dhe vetëm më vonë e ka marrë vesh se çfarë ka ndodhur.

Para se të publikohet vendimi i Gjykatës Themelore të Prishtinës, Konxheli bëri me dije se ai kishte kërkuar masën e arrestit shtëpiak për klientin e tij. Ai u vra pasi u qëllua mbrapa shpinës nga një i mitur, i cili

veproi në bashkëkryerje me pesë të dyshuarit e tjerë, rreth mesnatës së 1 prillit, pak pasi kishte hyrë në ndërtesën ku jeton, tha prokuroria.

Që të gjashtë të dyshuarit u arrestuan të hënën gjatë një operacioni të gjerë policor në Kaçanik dhe u dërguan në mbajtje për 48 orë.

Drejtori i Policisë së Kosovës, Gazmend Hoxha dhe kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Ferizaj, Burim Çerkini, thanë në një konferencë për medie në Ferizaj se dyshimet e para janë se motivet e vrasjes kanë të bëjnë me punën e rreshterit si zyrtar policor. "Dyshimet tona të deritanishme janë se vrasja e rreshterit tonë ka ndodhur për shkak të detyrës së tij zyrtare. Megjithatë, motivet do të qartësohen edhe pas intervistimit të personave të dyshimtë dhe pas ekzaminimit të dëshmive të gjetura. Kjo mbetet të vërtetohet", tha Hoxha.



Hoxha dhe Çerkini thanë se disa prej tyre kanë të kaluar kriminale dhe se Lika kishte punuar në zgjidhjen e disa rasteve ku ata dyshoheshin për vepra penale. "Disa nga të arrestuarit kanë pasur të kaluar kriminale dhe kanë qenë të arrestuar në të kaluarën për raste në lidhje me prirje ekstremiste", tha Hoxha. Megjithatë, avokatja Gashi-Bytyqi theksoi se në kërkesën për

masën e paraburgimit nga Prokuroria nuk përmendet as "lidhshmëri ideologjike islame" e as "që ka të bëjë me punën e policit".

Policia kreu bastisje në nëntë lokacione në Kaçanik dhe në një fshat të Klinës të hënën, duke sekuestruar dy vetura, telefona mobilë, disa laptopë, një armë zyrtare, maska, tyta armësh dhe fishekë.



ALBULENA HAXHIU DËSHTON PËRSËRI TË ZGJIDHET KRYETARE E KUVENDIT,
SEANCA SHTYHET PËR TË PREMTEN

VAZHDON BLLOKADA PËR FORMIMIN E INSTITUCIONEVE TË REJA

Edhe në përpjekjen e pestë deputetët kanë dështuar ta konstituojnë Kuvendin e Kosovës. Kandidatja e Lëvizjes Vetëvendosje, partisë fituese të zgjedhjeve, Albulena Haxhiu, dështoi të zgjidhej kryetare e Kuvendit. Opozita e kundërshtoi përsëri emërimin e Haxhiut. Kryesuesi i seancës, Avni Dehari, njoftoi se seanca e ndërprerë do të vazhdojë të premten në orën 11:00. E njohësit e proceseve politike kanë thënë se historikisht zgjedhja e kryetarit të Kuvendit ka qenë gjithmonë rezultat i marrëveshjeve politike

**EPOKA
ERE****Mal QORRAJ**

Prishtinë, 23 prill - Kandidatja e Lëvizjes Vetëvendosje, Albulena Haxhiu, ka dështuar të emërohet kryetare e Kuvendit të Kosovës në seancën e së mërkurës. Ajo i mori 57 vota për, katër më pak se 61 votat e nevojshme për emërimin e saj. Kundër saj votuan 46 deputetë, ndërsa abstenuan 3. Edhe në dy përpjekjet e kaluara Haxhiu kishte marrë vetëm 57 vota për. Seanca është shtyrë për të premten e 25 prillit. Pas kësaj seance deputetë nga LV-ja, PDK-ja, PDK-ja, AAK-ja dhe Nisma kanë dhënë qëndrimet e tyre në lidhje me këtë situatë. Deputeti i Kuvendit të Kosovës nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje, Hekuran Murati, ka thënë se deputetët nga partitë, që në legjislaturën e kaluar kanë qenë në opozitë, nuk janë të interesuar për konstituimin e Kuvendit të

Kosovës. “Janë totalisht të painteresuar ta zhblokojnë procesin, përkundrazi e bllokojnë, dhe nuk duan të hapin rrugë që të tjerët ta zhblokojnë. Me votën e tyre kundër [Albulena Haxhiut për kryetare të Kuvendit], ata po e pamundësojnë konstituimin e Kuvendit”, ka thënë Murati pas ndërprerjes së seancës. Murati ka theksuar se e propozuara e Lëvizjes Vetëvendosje për kryetare të Kuvendit, Haxhiu, e cila nga partitë e tjera po cilësohet figurë jounifikuese, është kandidatja më e votuar në legjislaturën aktuale. Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Memli Krasniqi, ka thënë se është “për keqardhje” që për herë të pestë ka dështuar seanca për konstituimin e Kuvendit të Kosovës, teksa për herë të tretë nuk është votuar kandidatja e propozuar për kryetare të Kuvendit, Albulena Haxhiu nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje (LV). Krasniqi ka thënë se “po rrëshqasim në një fazë që

asnjëherë s’i ka ndodhur Republikës së Kosovës”. “Lëvizja Vetëvendosje, së cilës i takon ta propozojë kryetarin e Kuvendit, ka vendosur ta mbajë peng shtetin për shkak të tekeve për një emër të përvetshëm”, është shprehur ai. “Nuk mund t’ua imponojmë emrin deputetëve të opozitës”, ka thënë Krasniqi, duke shtuar se mentaliteti arbitrar i marrjes së votës me zor nuk ka vend në një sistem demokratik. Krasniqi ka thënë se LV-ja tashmë e di që “dy kandidatë nga grupi i tyre parlamentar i marrin votat e mjaftueshme” për kryetar të Kuvendit. Por, sipas tij, synimi i LV-së është bllokada e Kuvendit. Ai ka thënë se partia e tij do ta votonte “një kandidat ose kandidat që nuk ka histori të përçarjes”. Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Lumir Abdixhiku, ka thënë se partia e tij nuk do ta mbështesë kandidaten e Lëvizjes Vetëvendosje për kryetare të Kuvendit. “Jemi të qartë,

bindjet tona janë se partia e parë duhet ta ofrojë një kandidat që përfaqëson Kuvendin, jo një kandidat që lexon skriptet e partisë. Ne jemi në opozitë dhe synojmë të jemi në opozitë”, ka thënë Abdixhiku. Ai ka theksuar se nëse partitë që kanë shprehur gatishmëri për bashkëpunim me partinë fituese nuk arrijnë marrëveshje, edhe seanca e sotme do të dështojë. “Partia e parë e ka detyrë të gjejë kompromis me partitë që i kanë shprehur gatishmëri për bashkëpunim, nëse nuk ka pasur marrëveshje për kryeparlamentarin, atëherë edhe kjo seancë është e kotë. Është e çuditshme sesi një parti që ka 48 deputetë nuk arrin ta bëjë një shumicë me 61 deputetë”, është shprehur ai. Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, ka thënë se partia e tij është e interesuar të zgjidhet kryetari dhe nënkryetarët e Kuvendit të Kosovës. “Më vjen keq që Lëvizja Vetëvendosje (LV) s’po ka mirëkuptim për kalimin e kësaj situate”, është shprehur ai në hollin e Kuvendit, pasi kandidatja e LV-së për kryetare të Kuvendit, Albulena Haxhiu, nuk i mori votat e nevojshme. “Beteja politike nuk është zhvilluar asnjëherë për kryetar Kuvendi dhe për konstituim Kuvendi”, ka thënë Haradinaj, duke shtuar se

qëndrimet e AAK-së janë të qarta. “Qëndrimet tona sa i përket qeverisë i dini, jemi për qeveri të opozitës”, ka shtuar ai. Haradinaj ka thënë se “nëse LV-ja gjen zgjidhje tjetër, të shohim si do të ecë tutje”. “Do të ishte në interesin e tyre ta prezantojnë një kandidaturë unifikuese, që të kalojë ky bllokim”, ka deklaruar kreu i AAK-së. Haradinaj ka thënë se përgjegjësia për dështimin e seancës për konstituimin e Kuvendit bie mbi LV-në. “Faji bie mbi atë që s’e ka shumicën e s’jep option bashkëpunimi. Nëse u duhen votat tona, duhet bashkëpunim”, është shprehur ai. Haradinaj ka folur edhe për mundësinë e shpërbërjes së Kuvendit dhe shkuarjes drejt zgjedhjeve të reja, teksa ka thënë se “edhe për të shkuar në zgjedhje duhet dakordimi i opozitës”. Kryetari i Nismës Social-demokrate, njëherësh deputet, Fatmir Limaj, ka shprehur shpresën se situata politike në vend do të zgjidhet së shpejti. Ai theksoi se procesi i konsolidimit të institucioneve është i vështirë dhe kërkon angazhim nga të gjitha palët. “Kosova nuk e ka luksin të mbetet pa institucione”, u shpreh Limaj, duke shtuar se pret që në ditët në vijim të ketë lëvizje pozitive drejt formimit të tyre. “Shpresoj që gjërat do të ndryshojnë në vijim. Vërtet është pak një

KUSH PO E BLOKON FORMIMIN E INSTITUCIONEVE?!



Behxhet Sh.
SHALA - BAJGORA

Fizkultura e Kurthit: Eksperti për hajvanë dhe hajvanat, Albin Kurthi, natën kur arriti fitoren e Pirros, më tepër se 450.000 votuesve dhe familjeve të tyre, me një alkimi prej sadisti ua ndryshoi biologjinë dhe fiziologjinë, nga njerëz i bëri kafshë, nga të vetëdijshëm dhe të arsyeshëm, i bëri të udhëhiqen nga instinkti prej kafshe. Militantët e pranuan këtë thuaja si diçka normale, aspak për çudi. Albin Kurthi tha se LV-ja do ta ketë kryetarin e Kuvendit dhe se të njëjtën ditë do ta kemi qeverinë Kurthi 3 ku ai do të jetë KM. Tha se i kanë votat pastaj. Këtë e pohuan edhe personalitete të shquara

njerëzore, intelektuale dhe politike të LV-së, të njohur që kurrë në jetën e tyre nuk kanë gënjyer, madje as më 1 prill kur edhe lejohet “shmangia nga e vërteta”. Po kush do të dyshonte në singleritetin e Zdravo Mimosës, Mef Bajçinës, kumbarës së Spasiqëve të Obiliqit, Dilmalit, anarkistit proamerikan të Putinit e deri te marioneta që kinse po e drejton Kuvendin. Votat, ose i kanë, ose nuk i kanë. Votat përcaktuese janë në prapancën e Fatmir Limajt, LV-ja edhe aty i ka futur hundët, për një bythë karrige dhe pushteti. Tash, Fatmir Limaj është shndërruar në hamshor politikë, vetëm a mundet, i kërcen kujt të dojë, për tre vota. As Kazanova nuk i kishte këto rrethana dhe mundësi! LV-ja do me çdo kusht që për kryetar të Kuvendit ta ketë një marionetë femër të cilën do ta përdorë Kurthi, në kohën e duhur dhe në mënyrë të duhur, sidomos pasi të shkojë në shportë Vojsa Osmani, si material që nuk riciklohet më. Atëherë Lenka do të jetë pykë e dyfishtë bllokuese, si kryetare eventuale e Kuvendit dhe si

presidente në detyrë, deri në zgjedhje të të parit / parës së vendit. Kurthi KM, me marionetën Lenkën si kryetare e Kuvendit dhe fotokopje e noterizuar e Vojsa Osmanit, e bënë shylevek të një autokracie dhe diktature të pashmangshme me ç’rast Koreja e Veriut do të ishte super demokratike krahasuar me Kosovën. Lenkën nuk po e votojnë që të bëhet Elisa Spiropali e Kosovës ndonëse shumë ka investuar në pamjen e jashtme apo ambalazhimin, e brendshmja mbetet e ashtëzuar në mungesën kronike të integritetit profesional. Prandaj edhe pranon rolet sipas skenarit të Dejana kapuçekuqes dhe Albin “Cezarit”. Ky nipi politik i Arkanit në një emision të prostitucionit informativ e pati quajtur “iron laddy” apo në shqip, zonja teneqe. Albinit i përshtatet shfaqja ku në çdo 48 orë ia ngrehë penjtë, zonjës Teneqes. Kurthi e ka përsosur sistemin Matrjushka, sistem rus ku brenda trupit të një kukulle mëshihen kukulla tjera. E nxjerr marionetën Vojsa Osmani, del mationeta Dehari, e radhës është

marioneta Lenka, deri te marioneta e radhës. Është situatë jonormale, Kurthi, Mihalidis dhe rrogëtarët e tyre bëjnë be dhe rrëfen në kokë të Lenkës sepse është pykë e fortë për të ardhmen, nuk lë ëndërr pa ia realizuar Fidelit të Kosovës. Natyrisht, nëse e lejon opozita. Nëse Lenka bëhet Elisa Spiropali e Kosovës me 61 - 62 deputetë, do të fundoset përfundimisht, askush nga opozita nuk bashkëpunon me te, më vonë edhe pozitës do t'i bëhet barrë e që do ta hedhin në deponinë e mbeturinave. Sikur edhe shumë të tjerë!

Kjo është lojë e Kurthit, opozita është Kurth-uar në këtë kurthë. Është lojë pa kufi, pa afate dhe ikje nga afati 15 ditësh për formim të qeverisë. Kurthi nuk i donë shqiptarët, as kosovarët e as Nexhmedin Spahiun, nuk e do as Shqipërinë, vetëm pushtetin e do. Veten në pushtet dhe pushtetin nën Kurthin, nuk ka mundësi tjera. Deputetët i ka prona dhe piona të shahut, iu premtan se i bënë mbretëresha ndërkaq më së shumti i bënë ushtarë të baltës apo kuaj me liri

të lëvizjes dhe mendimit të kufizuar, si shkronja L, aq lëvizë kali i shahut dhe gomari i politikës. Kosova është në bllokadë nga injorantët, dashakeqët, antikombëtarët dhe dhunuesit e vullnetit qytetar. Kosovës po ia fikin dritat kriminelët e ZRrE dhe ata të politikës. Kosova është pa miq, ka bërë shumë armiq. Populli duhet t’ua tregojë derën, edhe kriminelëve të ZRrE-së si dhe politikanëve shpërdorues të votës së tyre.

Dikush duhet të tregohet dhe dëshmojë se është më pak budalla se tjetri, për të mbijetuar si popull dhe si shtet. Ndryshe, ikëm përlesh! Në atë rrugë jemi, e jemi bërë njëkahëshe, pa alternativa tjera. Përbuzje popullit, shtetit dhe drejtësisë, lavdi marrëzisë! Ndërrojeni selinë e qeverisë, në vend të kabinetit qeveritar bëhuni Teatër i Kukullave në Dodonë. Hileqarë dhe të pashpirtë, të pa ndjenja dhe injorantë, tregtarë flamujsh dhe bashkimit kombëtar. Askush më nuk iu besoni! Thëfshi qafën pa të keqen e askujt! Rrasuni pushtet duke shkatërruar shtet!

VENDOSËT AFATI PËR MOCIONIN E MBROJTJES PËR RRËZIMIN E AKUZAVE NË RASTIN NDAJ LIDERËVE TË UÇK-së

HAGË, 23 PRILL - Në çështjen gjyqësore ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit janë vendosur disa afate kohore lidhur me mocionin e ekipeve mbrojtëse për rrëzimin e akuzave në aktakuzë. Kryetari i trupit gjykues, Charles Smith II, ka thënë se trupi gjykues e urdhëron mbrojtjen që mocionin e saj ta dorëzojë deri më 2 qershor ose pas 14 ditësh pas vendimit të fundit të trupit gjykues lidhur me provat e Prokurorisë, raporton “Betimi për Drejtësi”. Trupi gjykues ka theksuar se nuk

do t’i shqyrtojë kundërpërgjigjet dhe kjo parashihet me Rregulloren e Procedurës dhe Provave. Ndërsa ZPS-ja është urdhëruar që përgjigjen e saj në mocionin e mbrojtjes ta dorëzojë deri më 1 korrik 2025 ose brenda 30 ditësh nga mocioni i mbrojtjes. Veç kësaj, në këtë rast, trupi gjykues ka rritur në 20 mijë fjalë parashtrimin që mund ta dorëzojë mbrojtja, ngjashëm edhe për përgjigjen e prokurorisë. Pasi është ankuar mbrojtja duke u arsyetuar se ky numër nuk është i mjaftueshëm që katër ekipet t’i paraqesin çështjet e tyre dhe si



rrjedhë trupi gjykues ndryshoi vendimin, duke shtuar edhe 3 000 fjalë të tjera. Urdhër është dhënë edhe për mbrojtësin e viktimave, i cili është

obliguar që deri më 28 maj 2025 ta dorëzojë një listë të dëshmitarëve të propozuar, në rast që dilet me përfundimin se trupi gjykues ka çfarë të gjykojë në

këtë çështje. Është kërkuar nga mbrojtësi i viktimave të njoftojë për parashikimet kohore në pyetjet e dëshmitarëve të saj dhe se çfarë materialelesh dëshiron që të përdorë. Kur jemi te materialet, iu kërkuar mbrojtësit të viktimave që të njoftojë se si do të kërkohet pranimi i këtyre materialeve. Po ashtu, janë urdhëruar palët ta njoftojnë trupin gjykues që deri më 9 qershor a i kundërshtojnë provat e mbrojtësit të viktimave dhe cilat nga to, po ashtu edhe kohën që parashikojnë për marrjen në pyetje të këtyre dëshmitarëve.

Gazetarët bojkotojnë kryeministrin në detyrë, Albin Kurti

PRISHTINË, 23 PRILL - Gazetarët dhe kameramanët e medieive vendore kanë vendosur mikrofonat e kamerat e tyre në tokë, këtë të mërkurë, në kohën që kryeministri në detyrë,

Albin Kurti, po dilte nga ndërtesa e Kuvendit të Kosovës për të shkuar në qeveri. Ky veprim i gazetarëve ka ndodhur në shenjë proteste pasi që Kurti nuk e ka thënë asnjë fjalë

për mediet në asnjërën nga pesë mbledhjet e Kuvendit brenda një jave. Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës i ka ftuar të gjithë aktorët politikë, në këtë rast më së shumti kryetarin e partisë

që ka fituar më së shumti ulëse në Kuvend, që të jetë transparent me mediet dhe publikun, për një temë kaq të rëndësishme siç është konstituimi i legjislaturës së re.



lojë nervash, por konstituimi i ka vështirësitë e veta. Besoj se këtë ditë në vijim të gjithë do të angazhohen për të kontribuar për të dalë nga kjo situatë dhe Kosova t’i fitojë institucionet e veta. Një gjë duhet ta kemi të qartë, më e rëndësishme se çdo gjë tjetër, Kosova nuk e ka luksin të mbetet pa institucione. Shpresoj të bëhet sa më parë”, ka thënë Limaj.

Kryeziu: Historikisht zgjedhja e kryetarit të Kuvendit ka qenë gjithmonë rezultat i marrëveshjeve politike

Ismet Kryeziu nga KDI-ja ka thënë se posti i kryetarit të

Kuvendit nuk është as teknik, as neutral, është një pozitë politike me peshë të madhe dhe përgjegjësi të qarta brenda funksionimit parlamentar. “Historikisht, zgjedhja e kryetarit ka qenë gjithmonë rezultat i marrëveshjeve politike mes koalicioneve qeverisëse, i shumicës parlamentare, jo një vendim apo imponim i njëanshëm.

Nuk mund t’i kërkosh votat e opozitës pa asnjë marrëveshje e pastaj ta akuzosh për bllokim, vetëm pse nuk ta voton kandidatin e propozuar. Kjo nuk është as përgjegjësi politike, as kulturë demokratike. Është arrogancë politike dhe injorim i rolit që ka opozita në një sistem parlamentar”, ka thënë Kryeziu.

Ai ka shtuar se sa iu përket argumenteve si “kush ka marrë më shumë vota nga qytetarët” apo “kush është kandidati dhe çka përfaqëson”, janë pa asnjë peshë në këtë fazë. “Vota për kryetarin e Kuvendit është përgjegjësi e deputetëve dhe varet nga marrëveshjet politike që sigurojnë shumicën, jo nga retorika publike”, ka deklaruar Kryeziu.

OSMANI: ÇDO MARRËVESHJE PAQEJE NUK DUHET T'I INKURAJOJË AMBICIET IMPERIALISTE TË RUSISË

HELSINKI, 23 PRILL - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, e cila po qëndron për vizitë zyrtare në Finlandë, theksoi rëndësinë që çdo marrëveshje e ardhshme paqeje mes Ukrainës dhe Rusisë të mos e inkurajojë Moskën që t'i "ndjekë më tej ambiciet e saj imperialiste dhe territoriale ndaj vendeve të tjera". "Dhe, nuk po flas vetëm për këtë pjesë të Evropës - po flas edhe për Ballkanin Perëndimor, sepse ka pasur gjithmonë një qëllim tradicional dhe historik të Rusisë për të krijuar një efekt zinxhir", tha Osmani të mërkurën në një konferencë të përbashkët për medie me presidentin e Finlandës, Alexander Stubb, në Helsinki. Osmani deklaroi se nëse i bëhen lëshime Rusisë, vetëm sepse është më e madhe dhe ka më shumë armë, "kjo është e rrezikshme për pjesën tjetër të botës dhe jo vetëm për kontinentin evropian". Ajo tha se beson se është shumë e rëndësishme që presidenti amerikan Donald Trump po i kushton vëmendje vuajtjes njerëzore. "Kur kemi një qasje të përqëndruar te njeriu, atëherë paqja është e mundur", u shpreh Osmani. Presidentja e Kosovës argumentoi se objektivi i Kremlinit shkon përtej pushtimit territorial, duke synuar ta minojë unitetin evropian dhe t'i diskreditojë sistemet me vlera të Bashkimit Evropian dhe Organizatës së Traktatit të Atlantikut Verior (NATO). "Sepse, përtej territoreve, ajo që dëshiron [presidenti rus, Vladimir] Putin është një Evropë e paqëndrueshme. Ajo që dëshiron Putin është të japë mesazhin se sistemet me vlera



që përfaqësojnë Bashkimi Evropian dhe NATO janë një dështim. Nuk duhet t'i japim këtë argument, sepse Kosova është një dëshmi e suksesit të Bashkimit Evropian, NATO-s dhe partneritetit transatlantik". Ajo tha se është e rëndësishme që marrëdhënia transatlantike ndërmjet Evropës dhe Shteteve të Bashkuara të mbetet e fortë, "sepse historia na ka treguar se vetëm kur kjo marrëdhënie është e fortë, shohim suksese që kontribuojnë në një Evropë të bashkuar, të lirë dhe në paqe". Osmani ndodhet në një vizitë dyditore në Finlandë. Gjatë takimit me presidentin finlandez, Stubb, ata diskutuan për marrëdhëniet dypalëshe

mes Finlandës dhe Kosovës, për luftën në Ukrainë, situatën në Ballkanin Perëndimor dhe sigurinë evropiane. Presidenti i Finlandës tha gjatë konferencës për medie se pasojë e papritur e luftës agresore të Rusisë në Ukrainë është se Evropa është më e bashkuar se kurrë dhe se integrimi evropian është rikthyer në agjendë. "Po, jemi dëshmitarë të lindjes së një Perde të Re të Hekurt mes Evropës dhe Rusisë, dhe vendi i Kosovës është shumë i qartë. Është në zemër të Evropës, dhe, natyrisht, shpresojmë që Kosova do të bëjë çdo përpjekje për ta shfrytëzuar këtë mundësi drejt një integrimi më të thelluar në

zemrën e Evropës dhe anëtarësimit të ardhshëm në Bashkimin Evropian", tha ai. Të dy presidentët nuk pranuan të komentojnë mbi pyetjen e një gazetareje se çfarë do të ndodhte nëse Ukraina refuzon një marrëveshje, sipas së cilës do të humbte disa territore, dhe nëse ShBA-ja tërhiqet nga ky proces. Ata thanë se nuk do të komentojnë derisa të bëhet zyrtare se çfarë ndodh me procesin. "Është një punë e vështirë", tha Stubb, duke shprehur bindjen se përpjekja diplomatike do të vazhdojë.

Finlanda e mbështet Kosovën në rrugën drejt BE-së

Presidenti finlandez Stubb shtoi se Finlanda mbështet rrugën e Kosovës drejt BE-së, anëtarësimit e saj në Këshillin e Evropës, dhe se stabiliteti në rajon është i rëndësishëm për sigurinë evropiane. "Për ta përmbyllur, dialogu Beograd-Prishtinë është një hap thelbësor për ndërtimin e një stabiliteti afatgjatë në rajon. Ruajtja e paqes në Ballkanin Perëndimor është e rëndësishme jo vetëm për popujt e rajonit, por për Evropën në tërësi".

Osmani tha se Kosova ka zgjedhur dialogun si mjetin e vetëm për t'i zgjidhur çështjet e pazgjidhura, por shtoi se "paqja e qëndrueshme mund të ndërtohet vetëm përmes respektimit të plotë të marrëveshjeve ndërkombëtare dhe sundimit të ligjit, dhe në fund, duke mos mohuar apo ngacmuar fqinjin". "Fatqëqësisht, ne e kemi mësuar në mënyrën më të vështirë se çfarë do të thotë të kesh një fqinj që nuk i beson këtyre parimeve. Megjithatë, ne sërish kemi shtrirë dorën e bashkëpunimit, për të gjithë fqinjët tanë, sepse duhet të sigurohemi që fëmijët tanë, brezi i parë që ka njohur vetëm paqen dhe jo luftën, të mos përjetojnë kurrë atë që kemi përjetuar ne". Osmani tha, gjithashtu, se ajo ka propozuar që Kosova dhe Finlanda të punojnë së bashku për një marrëveshje më gjithëpërfshirëse në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes ndërmjet dy vendeve. Në kuadër të kësaj vizite, presidentja e Kosovës ndau Medaljen Presidenciale Ushtarake për Forcat e Armatosura të Finlandës, për kontributin e tyre për paqe e siguri në Kosovë, në kuadër të misionit paqeruajtës të NATO-s në Kosovë, KFOR.

Parlamenti i Finlandës ka qenë gjithmonë ndër zërat më të fortë në mbështetje të Kosovës

"Parlamenti i Finlandës dhe deputetët e tij kanë qenë gjithmonë ndër zërat më të fortë në mbështetje të Kosovës - në çdo hap të rrugëtimit tonë!", kështu ka thënë Osmani në Helsink, në takim me kryetarin e

Parlamentit, Jussi Halla-aho, dhe me shumë deputetë të tjerë. Presidentja Osmani ka shprehur mirënjohjen e thellë për mbështetjen e palëkundur dhe për rolin e tyre vendimtar në avancimin e anëtarësimit të Kosovës në Këshillin e

Evropës dhe në organizata të tjera ndërkombëtare. "Bashkë, diskutoam për hapa të rinj që do ta thellojnë partneritetin tonë dhe do të forcojnë bashkëpunimin në fusha strategjike", ka thënë presidentja pas takimit.

Totaj pret në takim ambasadorin e Francës, flasin për projektet e mjedisit dhe ekologjisë

PRIZREN, 23 PRILL - Kryetari i komunës së Prizrenit, Shaqir Totaj, ka pritur në takim ambasadorin e Francës në Prishtinë, Olivier Guerot, me të cilin ka biseduar për mundësitë e bashkëpunimit

konkret në mes të komunës së Prizrenit dhe Agjencisë Franceze. "Me kënaqësi prita sot ambasadorin e Francës në Prishtinë, Olivier Guerot, me të cilin diskutoam për mundësitë

bashkëpunim konkret në mes të komunës së Prizrenit dhe Agjencisë Franceze për Zhvillim në Kosovë, i cili do të fokusohet në realizimin e projekteve për përmirësimin e mjedisit, ekologjisë,

promovimin e energjisë së ripërtërishme, zhvillimin ekonomik dhe projekte të tjera që do të ndikojnë në rritjen e cilësisë së jetës së qytetarëve", ka njoftuar Totaj.



KOSOVA MBYLL SËRISH INSTITUCIONE TË SERBISË

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 23 PRILL - Autoritetet e Kosovës kanë mbyllur zyrat e Fondit të Pensioneve dhe Invaliditetit (Fondi PIO), Shërbimin Kombëtar të Punësimit dhe Fondin Republikan për Sigurime Shëndetësore në Leposaviq, në veri të Kosovës, si dhe Ndërmarrjen Publike Komunale në Shtërpçë, komunë me shumicë serbe në jug të Kosovës. Të gjitha këto institucione funksiononin sipas sistemit të Serbisë, të cilin Kosova e konsideron të paligjshëm dhe paralel. Zëvendësudrejtori i Policisë së Kosovës për rajonin e veriut, Veton Elshani, i tha "Radios Evropa e Lirë" se policia u ka asistuar autoritetet komunale në Leposaviq për t'i rikthyer ambientet e tyre dhe se gjatë aksionit janë zbuluar "aktivitete të paligjshme". "Jemi konsultuar me prokurorin për çështjen e Shërbimit Kombëtar të Punësimit dhe është hapur një rast për falsifikim dokumentesh. Do të intervistojmë një person në lidhje me këtë rast. Sa i përket Fondit për Sigurime Shëndetësore, nga sa di, komuna i ka dhënë afat një javë për t'i lëshuar hapësirat", tha Elshani. Edhe ministrja në detyrë e Ekonomisë, Artane Rizvanolli, njoftoi se është mbyllur Ndërmarrja Publike Komunale në Shtërpçë. "Asnjë institucion paralel i Serbisë nuk ka vend në Republikën e Kosovës. Nuk do të ketë asnjë lloj paralelizmi të institucioneve tona dhe asndonjë nënshtrim ndaj direktivave nga Beogradi në territorin e shtetit tonë", shkroi ajo në një postim në llogarinë e saj në "Facebook".

Institucionet sipas sistemit serb kanë funksionuar pas vitit 1999 në mjediset ku jetojnë serbët. Kosova i ka konsideruar ato të paligjshme, megjithatë ato janë toleruar. Megjithatë, Qeveria e Kosovës, e udhëhequr nga Albin Kurti, ka filluar mbylljen e tyre që nga fillimi i vitit 2024.



Deri më tani janë mbyllur organet e përkohshme komunale, qendrat për punë sociale, Posta e Serbisë, Banka Postare Kursimore dhe ndërmarrjet publike. "E falënderoj Policinë e Kosovës për mbështetjen, njëkohësisht

kërkoj prej saj dhe Prokurorisë që urgjentisht të hetojnë dëmet dhe përfitimet që ka shkaktuar veprimtaria e paligjshme e kësaj strukture paralele të Serbisë", shtoi Rizvanolli. Nga ana tjetër, Zyra për Kosovën në Qeverinë e Serbisë njoftoi se

autoritetet e Kosovës "në mënyrë të kundërligjshme po i mbyllin edhe ato pak institucione serbe që kanë mbetur në Kosovë". "E gjithë kjo po ndodh në praninë e bashkësisë ndërkombëtare, e cila në heshtje po vëzhgon

terrorin ndaj serbëve dhe përndjekjen e mëtejshme të popullit tonë", thuhet në deklaratën e Serbisë, me një thirrje për reagim nga bashkësia ndërkombëtare, veçanërisht nga Bashkimi Evropian, me ndërmjetësimin e të cilit po zhvillohet dialogu ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit për normalizimin e marrëdhënieve. Lista Serbe, partia më e madhe e serbëve në Kosovë, e cila ka mbështetjen e Beogradit, ka njoftuar se autoritetet e Kosovës, duke mbyllur institucionet serbe në Leposaviq dhe Shtërpçë, po përpiqen që "përmes presioneve, provokimeve dhe dhunës institucionale ta vështirësojnë edhe më shumë jetën e popullit serb në Kosovë". Nga kjo parti kanë deklaruar se aksioni për mbylljen e institucioneve serbe është "shkelje e drejtpërdrejtë e të gjitha marrëveshjeve, përfshirë edhe Marrëveshjen e Brukselit". "Ndërhyrjet në ndërtesa nuk do ta ndalojnë shtetin e Serbisë që të jetë pranë të gjithë të punësuarve dhe përdoruesve të shërbimeve që këto institucione ua ofronin të gjithë qytetarëve pa dallim kombësie", thuhet në njoftim.

Presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, në mesin e shtatorit të vitit të kaluar kishte deklaruar se nuk do t'i shfuqizonte institucionet për Kosovën dhe kishte paralajmëruar hapjen e "zyrave moderne" nga ana serbe në afërsi të pikave kufitare. Ai kishte premtuar se të gjithë punëtorët e institucioneve të mbyllura do të vazhdonin t'i marrin pagat dhe se do t'u ofronte çdo lloj mbështetjeje. Mbyllja e institucioneve që funksionojnë sipas sistemit serb po has në kundërshtim nga komuniteti serb, por edhe në kritika nga bashkësia ndërkombëtare, me arsyetimin se "aksionet e njëanshme dhe të pakoordinuara" mund t'i rrisin tensionet në terren. Gjithashtu, BE-ja ka deklaruar në fillim të këtij viti se statusi i strukturave të mbështetura nga Serbia pritet të zgjidhet përmes dialogut.

Rritja e çmimeve në Kosovë në muajin mars: kafeja, vezët, qumështi dhe perimet, më të shtrenjta

PRISHTINË, 23 PRILL - Çmimet e konsumit në Kosovë kanë shënuar rritje të ndjeshme gjatë muajit mars 2025 krahasuar me të njëjtin muaj të vitit të kaluar, 2024. Sipas të dhënave të publikuara nga Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK), indeksi i tërësishëm i harmonizuar i çmimeve të konsumit (IHÇK) ka shënuar një rritje mesatare prej 2,9 % në mars 2025 krahasuar me marsin e vitit 2024.

Siç bëhet me dije, rritja vjetore e çmimeve është

shoqëruar edhe me një inflacion mujor prej 0,8 % vetëm gjatë muajit mars 2025, duke reflektuar ndikimet e vazhdueshme nga faktorë të ndryshëm të tregut dhe të mjedisit ekonomik. Rritja e çmimeve është ndikuar kryesisht nga shtrenjtimi i mallrave dhe shërbimeve në disa nga grupet dhe nëngrupet më të rëndësishme të klasifikimit COICOP. Disa nga rritjet më të theksuara përfshijnë: kafe, çaj dhe kakao (17,1 %), perime (8,7 %), mish (8,3 %),

shërbime të transportit personal (7,6 %), qumësht, djathë dhe vezë (7,1 %), pemë (6,7 %), pije alkoolike (6,3 %), gazeta, libra dhe materiale për zyra (6,2 %), shërbime hoteliere (5,8 %), ujë mineral, pije joalkoolike dhe lëngje (5,4 %). Ndërsa sipas ASK-së, rënie të çmimeve në disa kategori kanë pësuar lëndët djegëse të ngurta (si dru zjarri, pelet etj.) me një rënie prej -6,7 %, karburantet dhe lubrifikantët për transportin personal me një rënie prej -5 %.



BISLIMI: TURQIA, NJË NGA INVESTITORET DHE PARTNERET TREGTARE MË TË MËDHA QË KA KOSOVA

BURSA, 23 PRILL - Zëvendëskryeministri i parë në detyrë për Integrim Evropian, Zhvillim dhe Dialog i Republikës së Kosovës, Besnik Bislimi, mori pjesë në ceremoninë e hapjes së Shoqatës Kulturore dhe Humanitare të Kosovës, Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut në Bursa të Turqisë. “Për ne në Kosovë, Bursa zë një vend të veçantë si qyteti me komunitetin më të madh shqiptar. Një komunitet që brez pas brezi për më shumë se një shekull ka vazhduar ta kultivojë dhe ta bartë gjuhën, kulturën dhe vlerat shqiptare. E një nga këto vlera shumë të rëndësishme për ne është mikpritja të cilën sot po e ndiejmë fuqishëm këtu”, tha zëvendëskryeministri Bislimi. Ai shtoi se Turqia është shteti me të cilin kemi marrëdhënie të fortë e të thellë, gjersa përtej lidhjeve tona kulturore e njerëzore, raporti i Kosovës me Turqinë po lulëzon edhe në rrafshin ekonomik. “Turqia tanimë është një nga



investitorët dhe partnerët tregtarë më të mëdha që ka Kosova. Vëllimi tregtar në mes të Kosovës dhe Turqisë e ka arritur shifrën prej një miliard eurosh. Bizneset turke kanë

investuar në Kosovë mbi 400 milionë euro, duke u kyçur në sektorë shumë të rëndësishëm si infrastruktura, energjia, financa, shëndetësia dhe arsimit. Janë diku 10 000 veta që

kanë gjetur punë nëpër korporata dhe ndërmarrje që kanë për pronarë biznese turke”, u shpreh zëvendëskryeministri. Ai theksoi se bashkëpunimin

ekonomik duhet ta kultivojmë secilën ditë e më shumë duke e institucionalizuar përmes iniciativave si ajo e fundit e komitetit të përbashkët ekonomik e tregtar në mes të Kosovës dhe Turqisë, që pritet t’i fuqizojë edhe më shumë raportet tona, duke sjellë mundësi të reja edhe për komunitetin shqiptar dhe bizneset shqiptare në Bursa. “Kjo mënyrë e organizimit e komunitetit shqiptar, si shoqata që po e përurojmë sot, janë iniciativa të vlefshme që e zgjerojnë bashkëpunimin tonë në vazhdim. Shoqata që po përurohet sot është më shumë sesa një organizatë kulturore e humanitare: ajo është edhe një emblemë që unifikon identitetin, përkatësinë dhe vlerat e komunitetit shqiptar në Turqi”, tha zëvendëskryeministri Bislimi. Ai e përfundoi fjalën duke i uruar të gjithë për hapjen e kësaj shoqate kulturore e humanitare si dhe duke i falënderuar për punën e vlefshme.

DELEGACIONI I BQK-së ZHVILLON TAKIME TË RËNDËSISHME NË SELINË E FMN-së

PRISHTINË, 23 PRILL - Delegacioni i Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), i kryesuar nga guvernatori Ahmet Ismaili, po vazhdon të zhvillojë takime të rëndësishme në Shtetet e Bashkuara të Amerikës në kuadër të Takimeve Pranverore 2025 të Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN) dhe Bankës Botërore (BB), që do të zgjasin nga 21 deri më 26 prill. Në takim me ekipin e Departamentit për Tregjet e Parasë dhe Kapitalit në FMN të kryesuar nga Jennifer Elliot, këshilltare rajonale në Departamentin për Tregjet e Parasë dhe Kapitalit në FMN, u diskutua mbi ecurinë e rekomandimeve të dhëna nga misionet paraprake të FMN-së, përfshirë Rishikimin e Stabilitetit të Sektorit Financiar (FSSR), Vlerësimin e Masave Mbrojtëse (Safeguard Assessment), si dhe nivelin e kënaqshëm të zbatimit të asistencave teknike të ofruara deri tani. Në veçanti u diskutua për vazhdimin e mbështetjes së FMN-së në fushat e mbikëqyrjes



bankare, të sigurimeve dhe pensione, stabilitetit financiar, sigurisë kibernetike, si dhe avancimit të kornizës institucionale dhe ligjore të BQK-së. Gjithashtu, delegacioni i BQK-së u prit edhe nga drejtuesit më të lartë të Institutit për Zhvillimin e Kapaciteteve (ICD) në FMN, i kryesuar nga drejtori Dominique Desruelle, ku diskutimet u fokusuan në mundësinë e mbështetjes së BQK-së për rishikimin dhe zhvillimin e modeleve makroekonomike të përshtatura për nevojat e sektorit

real dhe financiar në Kosovë, me qëllim forcimin e analizave për politikëbërje dhe parashikim ekonomik, si dhe ngritjen e kapaciteteve njerëzore në këtë fushë. Guvernatori Ismaili paraqiti prioritetet e BQK-së dhe falënderoi FMN-në për mbështetjen e vazhdueshme në këtë drejtim, derisa ekipet e FMN-së vlerësuan lart angazhimet e BQK-së. Në kuadër të vizitës zyrtare në Uashington, delegacioni i BQK-së ka zhvilluar takime bilaterale edhe me drejtuesit e



institucioneve partnere ndërkombëtare. Guvernatori Ismaili së bashku me delegacionin zhvilloi një takim edhe me Christian Rossler, zëvendëspresident për Banking, Huazim dhe Financim në institucionin Clearstream, pjesë e Grupit të Bursës Gjermane me seli në Luksemburg. Gjatë takimit u diskutua mundësia e krijimit të bashkëpunimit ndërmjet BQK-së dhe Clearstream në fushën e menaxhimit të rezervave ndërkombëtare, përfshirë ofrimin e shërbimeve të ruajtjes

(Custody), si dhe qasjen në produkte dhe shërbime të avancuara të tregjeve financiare, si huadhënia dhe huamarrja përmes letrave me vlerë. Zhvillimi i mëtejshëm i këtij bashkëpunimi do t’i mundësojë BQK-së të integrojë zgjidhje moderne teknologjike në proceset e menaxhimit të mjeteve, duke rritur efikasitetin operacional, njëkohësisht duke krijuar potencial për gjenerimin e të ardhurave shtesë përmes përdorimit të instrumenteve financiare në tregjet ndërkombëtare.

Rënie e përfituesve nga skemat e pensioneve krahasuar me vitin e kaluar

PRISHTINË, 23 PRILL - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka publikuar statistikën e mirëqenies sociale për muajin mars 2025. Në muajin mars 2025, krahasuar me muajin mars 2024, kishte rënie të numrit të përfituesve nga skema për pensionet invalidore (-35,7 %); skema për pensionet e Trepçës (-35,6 %); skema e

ndihmës sociale (-20,6 %); skema për pensionet familjare (-14,9 %); skema e pensioneve për personat me aftësi të kufizuara (-10,7 %); skema për familjet e dëshmorëve dhe invalidët e luftës (-3,2 %); skema e kompensimeve për personat e verbër (-2 %); skema e pensioneve kontributpaguese të moshës (-

0,9 %). Në muajin mars 2025, krahasuar me muajin mars 2024, kishte rritje të numrit të përfituesve nga skema për përkrahje financiare familjeve që kanë fëmijë me aftësi të kufizuara (24,7 %); skema e pensioneve të Forcës së Sigurisë së Kosovës (22,3 %); skema për Pensionet

Paraplegjike dhe Tetraplegjike (21,4 %); skema e kompensimit për punëtorët e arsimit që punuan gjatë vitit shkollor 1990/91 deri në vitin shkollor 1998/99 (10,7 %); skema e pensioneve bazike të moshës (12,7 %); skema e pensioneve të Trupave Mbrojtëse të Kosovës (TMK) (6,4 %); skema për veteranët e luftës (0,4 %).



AMERIKA U ZBULUA 7 HERË



Nga Nicholas R. LONGRICH

Kur Kristofor Kolombi zbarkoi në vitin 1492, Amerika ishte në fakt e banuar nga njerëzit prej dhjetëra mijëra vjetësh. Pra ai nuk ishte njeriu i parë që e zbuloi këtë kontinent. Mendohet se njerëzit e kanë zbuluar Amerikën të paktën në 7 kohë të ndryshme. Eksploruesit erdhën nga deti dhe toka, duke sjellë me vete gjene, gjuhë dhe teknologji të reja. Disa qëndruan, eksploruan dhe ndërtuan perandori. Të tjerët u kthyen në shtëpi dhe lanë disa shenja si për të treguar se dikur kishin qenë atje. Nga e fundit tek e para, ja cila është historia se si e zbuluam Amerikën:

7. Kristofor Kolombi: Vitet 1492 Pas Krishtit

Në vitin 1492, evropianët mund të shkonin në Azi nëpërmjet Rrugës së Mëndafshi, ose duke lundruar në Rrugën e Kepit përreth cepit jugor të Afrikës. Lundrimi në perëndim mendohej të ishte i pamundur. Grekët e lashtë e kishin llogaritur me saktësi se perimetri i Tokës ishte 40.000 km, gjë që e vendoste Azinë shumë larg në Perëndim. Por Kolombi gaboi në llogaritjet e tij. Perimetri i doli vetëm 30.000 km. Ky gabim, dhe disa supozime të tjera, e nxitën Kolombin të mendonte se distanca nga Evropa në Japoni ishte vetëm 4500 km. Ndërkohë distanca aktuale është gati 20.000 kilometra. Ndaj anijet e Kolombit u nisën pa furnizime të mjaftueshme

për të arritur në Azi. Për fatin e tij ai ndeshin rrugës Amerikën. Por duke menduar se kishte zbuluar Inditë Lindore, ai i quajti njerëzit e saj “Indios”, ose Indianë. Ai vdiq pa e kuptuar gabimin e tij. Ishte lundërtari Amerigo Vespuçi ai që e kuptoi se Kolombi kishte zbuluar një tokë të panjohur. Ndaj në vitin 1507 ky kontinent mori emrin e tij.

6. Polinezianët: Vitet 1200 Pas Krishtit

Rreth vitit 2500 Para Krishtit, një popull lundërtarësh u nis nga Tajvani për të zbuluar toka të reja. Këta njerëz lundruan në jug përmes Filipineve, në lindje përmes Melanezisë, më pas në Paqësorin e Jugut. Polinezianët ishin mjeshtra në lundrim, duke ditur të lexonin mirë erën, valët dhe yjet për të udhëtuar mijëra kilometra në oqean të hapur. Duke përdorur kanoe të mëdha, polinezianët nisën të vendosen në ishujt Samoa, Fixhi, Tongan dhe Kuk. Disa prej tyre shkuan në jug, në Zelandën e Re, duke u bërë Maori. Të tjerë shkuan në lindje në Tahiti, Hauai, Ishullin e Pashkëve dhe Markeze. Nga këtu, ata shkuan më në fund në Amerikën e Jugut. Por më vonë, pasi e kishin eksploruar pjesën më të madhe të Paqësorit, hoqën dorë nga eksplorimi dhe harruan plotësisht Amerikën e Jugut. Por mbetën gjithsesi dëshmitë e atij udhëtimit të jashtëzakonshëm. Amerikanët e Jugut morën pulat nga polinezianët, ndërsa polinezianët mund të kenë

marrë patatet e ëmbla të Amerikës së Jugut. Por ata ndanë më shumë sesa ushqimin. Polinezianët lindorë kanë ADN-në e amerikanëve vendas, pasi u martuan dhe patën fëmijë me ta.

5. Norvegjezët: Vitet 1021 Pas Krishtit

Sipas sagave të Vikingëve, rreth vitit 980 Pas Krishtit, Eriku i Kuq, një viking i egër dhe një tregtar shumë dinak, e quajti një shkretëtirë të madhe prej akulli “Grenlandë” për t'i joshur njerëzit të zhvendoseshin të banonin atje. Më pas, në vitin 986, një anije e vogël e nisur nga Grenlanda zbuloi brigjet e Kanadasë.

Rreth vitit 1021, djali i Erik, Leif, krijoi një vendbanim në Njufaundlend. Vikingët u përballën në fillim me klimën e ashpër atje, përpara se lufta me amerikanët vendas t'i detyronte ata të ktheheshin në Grenlandë. Këto histori u hodhën poshtë për një kohë të gjatë si mite. Kjo deri në vitin 1960, kur arkeologët gjetën mbetjet e vendbanimeve vikinge në Njufaundlend.

4. Inuit: Vitet 900 Pas Krishtit

Populli Inuit udhëtoi nga Siberia në Alaska përmes varkave prej lëkure. Duke u marrë me gjuetinë e balenave dhe fokave, dhe duke jetuar në kasolle dhe Igloo (shtëpi prej akulli), ata ishin përshtatur mirë me Oqeanin e ftohtë Arktik, dhe në një moment i

kaluan brigjet e tij deri në Grenlandë. Çuditërisht, ADN-ja e tyre është më afër me atë të banorët vendas të Alaskës. Kjo nënkupton se paraardhësit e tyre kolonizuan Azinë nga Alaska, dhe më pas u kthyen për të zbuluar sërish Amerikën.

3. Eskimo-Aleut: Vitet 2000-2500 Para Krishtit

Inuitët e kanë origjinën nga një migrim i mëparshëm: ai i folësve të gjuhëve Eskimo-Aleut. Këto janë të dallueshme nga gjuhët e tjera vendase amerikane, dhe madje mund të jenë të lidhura me gjuhët urale si finlandishtja dhe hungarishtja. Provat e ADN-së tregojnë se ajo e Eskimo-Aleut ishte një migrim i veçantë. Ata kaluan nëpër Detin Bering nga Rusia e sotme në Alaskë, ndoshta 4000-4500 vjet më parë, pjesërisht duke u zhvendosur dhe përzier me emigrantët e mëparshëm: popullin Na-Dene.

2. Na-Dene: Vitet 3000-8000 Para Krishtit

Një grup tjetër, Na-Dene, kaloi përmes Detit Bering për në Alaskë rreth 5000 vjet më parë. Edhe pse studime të tjera sugjerojnë se ata u vendosën në Amerikë deri në 10.000 vjet më parë. ADN-ja nga kockat e tyre nuk i lidh ata me njerëzit modernë të grupit Eskimo-Aleut, por me amerikanët vendas që flasin familjen e gjuhëve Na-Dene, si populli Navajo, Dene, Tlingit dhe Apash. Gjuhët Na-Dene, janë më të afërta me gjuhët e folura

në Siberi, duke sugjeruar sërish se ato përfaqësojnë një migrim të veçantë.

1. Amerikanët e parë: 16.000-35.000 vjet më parë

Tuajse të gjitha fiset vendase amerikane, Siuks, Komançë, Irokuis, Çeroki, Aztekët, Maat, Keçuat, Janomanit dhe dhjetëra të tjerë, flasin gjuhë të ngjashme. Dher kjo sugjeron se gjuhët e tyre evoluan nga një gjuhë e përbashkët paraardhëse, e folur nga një fis i vetëm që erdhi në Amerikë shumë kohë më parë. Diversiteti i ulët gjenetik i pasardhësve të tyre, sugjeron që ky fis themeltar ishte i vogël, ndoshta më pak se 80 njerëz. Por si arriti në Amerikë? Para se të përfundonte epoka e fundit akullnajore 11.700 vjet më parë, sasi të mëdha uji u bllokuan në akullnaja dhe niveli i detit ra. Fundi i detit Bering u tha, duke krijuar Urën Tokësore të Beringut. Pra njerëzit e parë të Amerikës shkuan në këmbë nga Rusia në Alaskë. Por koha e migrimit të tyre është ende e diskutueshme. Arkeologët mendojnë dikur se populli Klovis, që ka jetuar 13.000 vjet më parë, ishte kolonia e parë të Amerikës. Por tani provat e reja sugjerojnë se njerëzit mbërritën në Amerikë shumë më herët. Kështu disa gjurmë këmbësh të gjetura në Nju Meksiko datojnë 23.000 vjet më parë. Veglat prej guri në një shpellë meksikane mund të datojnë 32.000 vjet më parë. Dhe një mamuth i therur i gjetur i fosilizuar në Kolorado daton midis 31.000-38.000 vjet më parë. / “The Conversation” – Bota.al



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Llapi kualifikohet në finale të Kupës së Kosovës

SKENDERAJ, 23 PRILL - Llapi është finalisti i parë i Kupës së Kosovës për këtë sezon. Ekipi i drejtuar nga Tahir

Batatina e kishte fituar 2:0 në ndeshjen e parë në shtëpi ndaj Drenicës. E fitore të njëjtë ka shënuar edhe në

ndeshjen e kthimit të mërkurën në Skenderaj. Ishte Arianit Hasani që ka shënuar dy gola në pjesën e dytë për

fitoren e mysafirëve. Në finale, Llapi do të përballët me fituesin e duelit mes Prishtinës dhe Dritës.



Muriqi mund të largohet nga Mallorca në verë

MALLORCA, 23 PRILL - Pablo Ortells, drejtor sportiv i Mallorcas, ka folur rreth mundësisë që sulmuesi i kombëtares së Kosovës, Vedat Muriqi, të largohet nga klubi. Kohë më parë, Muriqi ka folur për këtë çështje, duke shprehur pakënaqësinë e tij rreth kontratës së re me klubin. Kjo, siç ka raportuar "Estadio Deportivo", ka sjellë një situatë në të cilën nuk përjashtohet mundësia që Muriqi të largohet nga Mallorca në merkaton e verës.

Një ikje e mundshme nuk përjashtohet as nga Pablo Ortells, drejtori sportiv i Mallorcas. Në një intervistë për gazetën "Marca", ai ka thënë se Muriqi është një lojtar i rëndësishëm dhe është një shenjë e mirë që ai dëshiron të vazhdojë me klubin. "Do të ishim të lumtur të vazhdojmë të llogarisim tek ai. Ai ka një kontratë në fuqi dhe kur të vijë

koha, shpresojmë që palët të arrijnë marrëveshje dhe ai të vazhdojë në Mallorca", ka thënë ai.

Pavarësisht kësaj tentative për të ulur tensionet, Pablo Ortells nuk ia ka mbyllur derën një largimi të mundshëm të Vedat Muriqit në merkaton e verës së ardhshme duke thënë se gjithçka mund të ndodhë kur ai është pyetur për të ardhmen e Muriqit, Larinit dhe Abdon Prats. "Tregjet janë të pasigurta dhe ne nuk mund të hamendësojmë të ardhmen. Të tre kanë kontrata dhe në këtë kuptim jemi të qetë. Asgjë nuk përjashtohet. Ata janë tanët dhe në verë do të shohim se çfarë do të ndodhë. Vedat Muriqi ka kontratë me Mallorcan deri më 30 qershor 2027, por dëshira e tij ishte të forconte lidhjen me klubin", ka thënë ai.

Kjo kërkesë, sipas "Estadio Deportivo", ka rënë në vesh të shurdhër, pasi sulmuesi nga



Kosova ka zbuluar se pas gjashtë muajsh pritje nuk kishte asnjë lëvizje nga Mallorca. Kjo nuk i ka pëlqyer Muriqit, i cili publikisht ka shfaqur shqetësimin e tij. "Më thanë të pres sepse duhej të flisnin me

bordin dhe kanë kaluar gjashtë muaj... Është e shëmtuar. Dhe është edhe më e shëmtuar për një lojtar që jep jetën në fushë për ekipin", ka thënë ai në një intervistë. Vedat Muriqi, këtë sezon ka

shënuar 7 gola në 26 ndeshje, duke shtuar 2 asistime. Sulmuesi është i lumtur te Mallorca, por prej kohësh kërkon një rinovim të kontratës që për momentin klubi ka preferuar ta shmangë.

Vinicius do ta vazhdojë kontratën me Realin



MADRID, 23 PRILL - Vinicius Junior është afër vazhdimit të kontratës me Real Madridin. Përkundër momentit të komplikuar, i cili kulmoi me eliminimin në çerekfinale të Ligës së Kampionëve nga Arsenali, "Los Blancos" po mendojnë qysh tash për të ardhmen. Braziliiani është afër vazhdimit të kontratës së tij aktuale, e cila do të skadojë më 30 qershor të vitit 2027. Sipas mediumit spanjoll "Cadena Ser", lojtari më i mirë në botë i shpallur nga FIFA do të nënshkruajë për tri vjet të tjerë, pra deri në vitin 2030.

Gjithnjë sipas mediumit spanjoll, besimi i klubit mbretëror karshi sulmuesit është total, kështu që marrëveshja mund të zyrtarizohet në javët në vazhdim. Reali nuk dëshiron ta humbasë absolutisht lojtarin, ndërsa në ditët e fundit ka pasur takime mes drejtuesve të klubit dhe përfaqësuesve të lojtarit, me synim që të gjendet gjuha e përbashkët para fundit të sezonit. Dëshira për ta vazhduar bashkëpunimin është reciproke, ndërsa vetë lojtari në një intervistë për kanalën zyrtar

të klubit e kishte përsëritur dëshirën e tij për ta vazhduar karrierën në Madrid. Natyrisht, nuk mungojnë skuadrat e interesuara për kartonin e tij, por për momentin situata është e qartë: Vinicius është afër ta hedh të zezën mbi të bardhë me "Merengues". Kështu, vështirësohet puna për klubet nga Arabia Saudite, të cilat janë të gatshme të paguajnë shuma marra-mendëse të parave për lojtarin. Megjithatë, kampionët e Evropës me këtë veprim do ta "blindonin" lojtarin dhe do t'i "trembnin" klubet nga Saudi Pro League.

PSG-ja thyen rekord: 39 ndeshje pa humbje në udhëtim, e kalon Milanin e Sacchit

PARIS, 23 PRILL - 39 ndeshje pa humbur kurrë në udhëtim. Paris Saint-Germaini, me barazimin 1:1 në shtëpi të Nantes, e ka thyer rekordin e Milanit të vitit 1993, i cili në atë kohë udhëhiqej nga Arrigo Sacchi.

Ai ekip ëndrrash në fakt ishte ndalur në kuotën e 38 ndeshjeve radhazi pa humbje në udhëtim.

Kjo është një arritje historike, që i përfshin pesë ligat më të forta evropiane, pasi askush nuk ka bërë më mirë se trupa e udhëhequr nga Luis Enrique. Asnjë humbje deri në këtë moment për parisienët, të cilët e kanë festuar tashmë titullin e kampionit falë 24 fitoreve e 6 barazimeve të regjistruara,

përfshirë këtu 83 gola të shënuar, statistika këto të pakapshme për Marseillen dhe për Monacon. Gjithçka ka nisur nga humbja në Monaco më 11 shkurt të vitit 2023 (1:3), ndërsa nga ajo kohë ekipi nga "Parku i Princave" nuk di se çka është humbja në 39 ndeshje radhazi në udhëtim në

Ligue 1, përfshirë këtu 30 fitore e 9 barazime. Praktiksht dy vjet e më shumë se dy muaj pa humbur. "Në fillim nuk ishte një objektiv, por po përmirësohemi dhe kjo është mjaft pozitive", deklaroi trajneri Luis Enrique për "DAZN", duke e komentuar këtë arritje historike të ekipit të tij.





Kompania Regjionale e Mbeturinave “Ambienti”Sh.A .Pejë
Me adresë Rr.Xhem Sadrija pn ,Fusha e Pejës-Tranzit KK Pejë

Bazuar ne ligjin e Punës: LIGJI Nr. 03/L-212 sipas nenit 8,dhe në bazë të Udhëzimit Administrativ MFPT- NR 01/2024, Kryeshefi Ekzekutiv i Kompanisë Regjionale të Mbeturinave “Ambienti” Sh .A .Pejë me datë 24.04.2025, shpall konkurs të brendshëm për këto vende të punës :

KONKURS I BRENDSHËM

Pozita : Mbledhës i borxheve (Inkasant) - 1 pozitë

Vendi punës : Pejë
Kohëzgjatja e kontratës : Me kohë të pacaktuar
Koeficienti i pagës 1.8

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës:

- Obligohet që në terren të silltet korrekt dhe të ketë të veshur uniformë dhe shenjë identifikimi të ndërmarrjes NPL Ambienti Sh.A;
- Dërgon faturat e printuara mujore që është i ngarkuar tek secili klient. Çdo parregullësi në faturë duhet ta kthej në rillogaritje (korrigjim) tek shefi i faturimit dhe inkasimit dhe arkëton pagesat më bllok të vërtetuar nga ndërmarrja;
- Përcjell gjendjen në terren dhe regjistron klientë të rinj, ndërrimin e pronarëve, pasvizizimet, korrigjimet e adresave dhe merr shënimet tjera të cilat i përkasin punëve dhe detyrave të inkasantit në lidhje me terrenin e tij dhe të njëjtat i dorëzon te shefi i inkasimit dhe faturimit;
- Dorëzon arkëtimet e pagesave me shënimet e duhura tek faturistët;
- Në bazë të raportit të lëshuar nga faturistët (Arkëtimi sipas Dokumenteve Analitke), kontrollon raportin së a janë në përputhje me pagesat në bllokun e dorëzuar dhe pasi që janë të gjitha në rregull bën dorëzimin e mjeteve në arkë;
- Pas dorëzimit të mjeteve në arkë, nënshkruan mandatat arkëtim të dokumentit dhe atë urdhër e ruan për barazim mujor tek shefi i inkasimit dhe faturimit;
- Jep përgjegjësi për çdo dëftesë të lëshuar nga blloku i tij me numër serik;
- Jep përgjegjësi për çdo faturë të dyfishuar dhe çdo formë tjetër, ku dëmtohet buxheti i ndërmarrjes;
- Kryen punë bazuar në kontratën e punës, por edhe punë të tjera me urdhëresë të shefit të inkasimit dhe faturimit; 32
- Është i detyruar të zbatojë disiplinën në punë, kodin e etikës, rregulloret / rregullat e caktuara nga ndërmarrja, ku për këtë proces pune dhe në rast të shkeljes së tyre mban përgjegjësi disiplinore;
- Për mos respektimin e pikave të lartëcekura i përgjigjet drejtpërdrejt, Kryeshefit Ekzekutiv.

- a. Kushtet e përgjithshme :**
- CV ;
 - Çertifikatë që kandidati nuk është nën hetime ;
 - Letër motivimi ;
 - Kopja e letërnjoftimit ;
 - Çertifikatë mbi gjendjen shëndetësore ;

- b. Kushtet e veçanta: (kualifikimet profesionale)**
- Shkolla e mesme (preferohet shkolla e mesme ekonomike);
 - Përparësi përvojë pune e dëshmuar;
 - Ai /Ajo duhet të jenë në gjendje të punojnë nën presion, të ketë moral të fortë për punë dhe integritet të nivelit të lartë.

Pozita : Kryepunëtor i servisit - 1 pozitë

Vendi punës : Pejë
Kohëzgjatja e kontratës : Me kohë të pacaktuar
Koeficienti i pagës 2.7

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës:

- Obligohet që të silltet korrekt dhe të mbajë uniformë dhe pasijet mbrojtëse me shenjë identifikimi të ndërmarrjes;
- Bën kontrollimin e të gjitha automjeteve, makinave ndërtimore dhe organizon e kontrollon kryerjen e punëve në punëtori;
- Kujdeset që automjetet e kompanisë të jenë të pastra dhe teknikisht në rregull, duke përfshirë sistemin e drejtimit, sistemin e frenimit, sistemin e pompave të pajisjeve përpunuese të mbeturinës, sistemin e ndriçimit dhe është përgjegjës për rregullsinë e çdo automjeti që del nga autoparkingu i NPL Ambienti Sh.A;
- Është i detyruar që të urdhërojë sanimin elektrik/ mekanik dhe tekniko-esplotues në kohë sa më të shpejt, në mënyrë që mos ta lejojë asnjë automjet të dal nga autoparkingu i NPL Ambienti Sh.A nëpër itineraret;
- Drejtpërdrejt udhëheq operativën e mirëmbajtjes, si dhe mban evidencë për servisimet e të gjitha automjeteve të NPL Ambienti Sh.A, si dhe parashikon servisimet në bazë të manualit të prodhuesit;
- Kontrollon dhe kujdeset për përdorimin e mjeteve mbrojtëse në punë;
- Përpilon analizën mbi harxhimet e pjesëve rezervë për automjete dhe është i obliguar të ketë në stok pjesë dhe pajisje rezervë që kërkojnë intervenime më të shpeshta.
- Kontrollon shfrytëzimin e kohës së punës dhe njofton menaxherin e operaives lidhur me problemet e kësaj natyre;
- Jep urdhëresë për riparimin e automjeteve dhe kontrollon kualitetin e kryerjes së punëve në mirëmbajtje;
- Kontrollon riparimet/mirëmbajtjen rrjedhëse të mesme dhe gjenerale në automjetet s'i dhe lyerjen dhe larjen e tyre;
- Raporton punen javore, mujore dhe vjetore tek menaxheri i operativës;
- Kryen punë të tjera me urdhëresën e menaxherit të operativës;
- Është i detyruar të zbatojë disiplinën në punë, kodin e etikës, rregulloret / rregullat e caktuara nga ndërmarrja për këtë proces pune dhe në rast të shkeljes së tyre mban përgjegjësi disiplinore;
- Për mos respektimin e pikave të lartëcekura i përgjigjet drejtpërdrejt, Kryeshefit Ekzekutiv

- a. Kushtet e përgjithshme :**
- CV ;
 - Çertifikatë që kandidati nuk është nën hetime ;
 - Letër motivimi ;
 - Kopja e letërnjoftimit ;
 - Çertifikatë mbi gjendjen shëndetësore ;

- b. Kushtet e veçanta: (kualifikimet profesionale)**
- Shkolla e mesme - drejtimi autoelektricist, automekanik me përparësi Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike;
 - 2 (dy) vite përvojë pune;
 - Aftësi organizative-menaxheriale;
 - Ai /Ajo duhet të jenë në gjendje të punojnë nën presion, të ketë moral të fortë për punë dhe integritet të nivelit të lartë.

Pozita : Ngasës kamioni - 1 pozitë

Vendi punës : Pejë
Kohëzgjatja e kontratës : Me kohë të pacaktuar
Koeficienti i pagës : 2.4

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës:

- Drejton automjetin, kujdeset për rregullsinë e tij dhe është përgjegjës për ngasjen e sigurtë, duke i respektuar rregullat trafikut rrugor dhe të sigurisë;
- Kujdeset për higijenën dhe pastërtinë e automjetit, si dhe para çdo ndezje të automjetit kontrollon gjithëmbarshtëm çdo pajisje dhe cep të automjetit dhe në momentin që vëren problem mekanik apo elektrik lajmëron kryepunëtorin, dhe nëse

- prishja ka ditë që nuk është rregulluar, lajmëron dhe MO, KE për problemin elektrik apo mekanik;
- Çdo ditë merr urdhëresën e punës nga kryepunëtori dhe koordinatori operativ në të cilën e shënon evidencën e punës dhe shpenzimeve;
- Është i obliguar që në automjet të ketë në rregull aparatin për fikjen zjarrit dhe paisjet përcjellëse të domosdoshme në komunikacion;
- Çdo ndalje për mbledhjen e mbeturinës është i obliguar që ta bëj sigurt dhe mundësisht në skajin e rrugës ose jashtë rrugës. Gjatë lëvizjes prapa dhe gjatë marrjes së mbeturinave me shpejtësi të vogël është i detyruar të lëshojë 4 treguesit e drejtimit dhe çdo herë për çdo veprim në trafik rrugor të jetë i sigurtë se ai veprim do të bëhet pa shkaktuar incident;
- Duhet të pajisjet me çertifikatë të rregullt shëndetësore për ngasje të automjetit dhe e njëjta të jetë valide;
- Nuk duhet të konsumojë duhan, alkool, apo narkotikë përgjatë drejtimit të automjetit, si dhe barëra të cilat kanë shenjë e trekëndëshit të sigurisë me ngjyrë të kuqe në vend të dukshëm;
- Në rast të prishjes së automjetit me të cilin punon është i obliguar që të drejton automjet tjetër dhe kryen edhe punë tjera me urdhëres të Kryepunëtorit, Kordinatorit Operativ;
- Është i obliguar te menaxhoi dhe të mbaj nën kontroll ekipin e punëtorëve fizik;
- Është i obliguar të mbajë uniformën e ndërmarrjes dhe PPM (pajisjet personale mbrojtëse);
- Kryen pune bazuar në kontratën e punës, por edhe punë tjera me urdhëresë të Kryepunëtorit,
- Për mos respektimin e pikave të lartëcekura i përgjigjet drejtpërdrejt, Kryeshefit Ekzekutiv

- a. Kushtet e përgjithshme :**
- CV;
 - Çertifikatë që kandidati nuk është nën hetime;
 - Letër motivimi;
 - Kopja e letërnjoftimit;
 - Çertifikatë mbi gjendjen shëndetësore.
- b. Kushtet e veçanta :(kualifikimet profesionale)**
- Përgatitje profesionale – Shkollim të mesëm, kategori përkatëse (C1-C);
 - Përparësi përvojë pune e dëshmuar;
 - Ai /Ajo duhet të jenë në gjendje të punojnë nën presion, të ketë moral të fortë për punë dhe integritet të nivelit të lartë.

Pozita : Depoist - 1 pozitë

Vendi punës : Pejë
Kohëzgjatja e kontratës : Me kohë të pacaktuar
Koeficienti i pagës : 2

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës:

- Disponon më të gjitha llojet e mallit në depo;
- Pranon dhe vërteton mallin e furnizuar me faturë të rregullt në emër të kompanisë dhe lëshon urdhëresën fletë- hyrje në depo të nënshkruar nga të dy palët;
- Furnizon stafin e ndërmarrjes me kërkesa të nënshkuara nga personat e autorizuar dhe lëshon urdhëresën fletë-dalje nga depo të nënshkruar nga të dy palët;
- Bën klasifikimin e mallit dhe është përgjegjës për pastrimin dhe ruajtjen e mallit;
- Bën kërkesën e mallit të nevojshëm me kohë dhe i drejtohet departamenteve përkatëse;
- Jep përgjegjësi për mos sinjalizimin me kohë të harxhimit të së mallit të nevojshëm;
- Raporton punën javore, mujore dhe vjetore tek kontablisiti;
- Është i obliguar në fund të vitit fiskal të bëj regjistrimin e mallit në depo;
- Detyrohet të zbatojë disiplinën në punë, kodin e etikës, rregulloret / rregullat e caktuara nga ndërmarrja për këtë proces pune dhe në rast të shkeljes së tyre mban përgjegjësi disiplinore;
- Kryen pune bazuar në kontratën e punës, por edhe punë tjera me urdhëresë të kontabilistit;
- Për mos respektimin e pikave të lartëcekura i përgjigjet drejtpërdrejt, Kryeshefit Ekzekutiv.

- a. Kushtet e përgjithshme :**
- CV ;
 - Çertifikatë që kandidati nuk është nën hetime ;
 - Letër motivimi ;
 - Kopja e letërnjoftimit ;
 - Çertifikatë mbi gjendjen shëndetësore ;
- b. Kushtet e veçanta: (kualifikimet profesionale)**
- Shkolla e mesme. përparësi diplomë Universitare;
 - 1 vit përvojë pune në punë të ngjajshme e dëshmuar;
 - Njohja e punës me kompjuter;
 - Ai /Ajo duhet të jenë në gjendje të punojnë nën presion, të ketë moral të fortë për punë dhe integritet të nivelit të lartë.

Pozita : Sigurim i Objektiv (Roje) - 2 pozitë

Vendi punës : Pejë
Kohëzgjatja e kontratës : Me kohë të pacaktuar
Koeficienti i pagës : 1.8

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës:

- Përcjellë hyrje-daljen e palëve, punëtorëve dhe automjeteve;
- Daljen e punëtorëve pa leje paraprake, të parakohshme i evidenton në libër të veçant;
- Palët duhet t'i jape fletëhyrjen dhe i orienton për në shërbimet për të cilat janë të interesuara;
- Është i obliguar për sjellje korrekte me pale dhe për qëndrim në vendin e tij të punës;
- Bënë sigurimin e objektivit në të cilin është përcaktuar në bazë të planit mujor;
- Bënë shiqimin e gjendjes së objektivit dhe mjeteve kundër zjarrit dhe rregullësis së tyre;
- Kontrollon dhe largon personat e paaautorizuar dhe të dyshimt që ndodhen afër objektivit.
- Ndërmerr masat e nevojshme në mbrojtjen e objektivit nga dukurit natyrore dhe për këtë lajmëron menjëherë shërbimet e specializuara;
- Pranon dhe dorëzon ndërrimin dhe për gjendjen e objektivit e informon punëtorin e sigurimit të radhës;
- Obligohet që në vendin e punës të mbajë uniformën;
- Pas orarit të rregullt të punës nuk guxon t'i lejoj hyrjen e personave të pautorizuar, përveç zyrtarëve të lartë të ndërmarrjes;
- Është përgjegjës i përgjithshëm i materialit dhe automjeteve, gjatë kohës së orarit të punës, me rastin e marrjes dhe dorëzimit të detyrës;
- Ndalon personat dhe automjetet e pa autorizuar dhe ndalon hudhjen e mbeturinave nga ana e popullatës lokale;
- Të kryej punë të cilat i besohen mbrenda ditës, të ketë kujdesë në punë në mënyrë që mos të vjen gjerë te ndezja e mbeturinave;
- Në rast të ndonjë avarie, ta evitojë atë dhe të lajmëroj shefin e sigurimit dhe organet Kompetente;
- o Ndhima e shpejtë – 194,
- o Emergjenca Civile – 112, 41
- o Zjarrfikësit – 193,
- o Policia – 119
- Të punojë të shtunave dhe të dielave.
- Kryen pune bazuar ne kontraten e punës, por edhe punë tjera me urdhëresë të shefit të sigurimit;
- Për mos respektimin e pikave të lartëcekura i përgjigjet drejtpërdrejt, Kryeshefit Ekzekutiv.

- a. Kushtet e përgjithshme :**
- CV ;
 - Çertifikatë që kandidati nuk është nën hetime ;
 - Letër motivimi ;
 - Kopja e letërnjoftimit ;
 - Çertifikatë mbi gjendjen shëndetësore ;

Kompania Regionale e Mbeturinave "Ambienti" Sh.A. Pejë
Me adresë Rr.Xhem Sadrija pn ,Fusha e Pejës-Tranzit KK Pejë

Bazuar ne ligjin e Punës: LIGJI Nr. 03/L-212 sipas nenit 8,dhe në bazë të Udhzimit Administrativ MFPT- NR 01/2024, Kryeshefi Egzekutiv i Kompanis Regionale të Mbeturinave "Ambienti"Sh.A. Pejë me datë 24.04.2025, shpall konkurs të jashtëm për këto vende të punës :

KONKURS

Pozita : Mbledhës i borxheve (Inkasant) - 1 pozitë

Vendi punës : Istog
Kohëzgjatja : Me kohë të caktuar 1 vitë me mundësi vazhdimi
Koeficienti i pagës : 1.8

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës:

1. Obligohet që në terren të sillt korrekt dhe të ketë të veshur uniformë dhe shenjë identifikimi të ndërmarrjes NPL Ambienti Sh.A;
2. Dërgon faturat e printuara mujore që është i ngarkuar tek secili klient. Çdo parregullësi në faturë duhet ta kthejë në rillogaritje (korrigjim) tek shefi i faturimit dhe inkasimit dhe arkëton pagesat me bllok të vërtetuar nga ndërmarrja;
3. Përcjell gjendjen në terren dhe regjistron klientë të rinj, ndërrimin e pronarëve, pasivizimet, korrigjimet e adresave dhe merr shënimet tjera të cilat i përkasin punëve dhe detyrave të inkasantit në lidhje me terrenin e tij dhe të njëjtat i dorëzon te shefi i inkasimit dhe faturimit;
4. Dorëzon arkëtimet e pagesave me shënimet e duhura tek faturistët;
5. Në bazë të raportit të lëshuar nga faturistët (Arkëtim i sipas Dokumenteve Analitike), kontrollon raportin së a janë në përputhje me pagesat në bllokun e dorëzuar dhe pasi që janë të gjitha në rregull bën dorëzimin e mjeteve në arkë;
6. Pas dorëzimit të mjeteve në arkë, nënshkruan mandat arkëtim të dokumentit dhe atë urdhër e ruan për barazim mujor tek shefi i inkasimit dhe faturimit;
7. Jep përgjegjësi për çdo dëftesë të lëshuar nga bloku i tij me numër serik;
8. Jep përgjegjësi për çdo faturë të dyfishuar dhe çdo formë tjetër, ku dëmtohet buxheti i ndërmarrjes;
9. Kryen punë bazuar në kontratën e punës, por edhe punë të tjera me urdhëresë të shefit të inkasimit dhe faturimit;
10. Është i detyruar të zbatojë disiplinën në punë, kodin e etikës, rregulloret / rregullat e caktuara nga ndërmarrja, ku për këtë proces pune dhe në rast të shkeljes së tyre mban përgjegjësi disiplinore;
11. Për mos respektimin e pikave të lartëcekura i përgjigjet drejtpërdrejt, Kryeshefit Ekzekutiv.

a. Kushtet e përgjithshme :

- CV ;
- Çertifikatë që kandidati nuk është nën hetime ;
- Letër motivimi ;
- Kopja e letërnjoftimit ;
- Çertifikatë mbi gjendjen shëndetësore.

b. Kushtet e veçanta :(kualifikimet profesionale)

- Shkolla e mesme (preferohet shkolla e mesme ekonomike);
- Përparësi përvojë pune e dëshmuar;
- Ai /Ajo duhet të jenë në gjendje të punojnë nën presion, të ketë moral të fortë për punë dhe integritet të nivelit të lartë.

Mënyra e Aplikimit:Dokumentacioni duhet të dërgohen ne e-mailit krmambientikonkurset@gmail.com
Data e për aplikim është nga 24.04.2025 deri me 09.05.2025 ora 12:00. Dokumentacioni që mbërrin pas afatit dhe i pakompletuar do të konsiderohet i pavlefshëm.. Dokumentet origjinale mund të kërkojnë, sipas nevojës. Vetëm kandidatët e selektuar për listën e ngushtë do të kontaktohen.

Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo

Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

NJOFTIM PËR ANULIM TË KONKURSIT

Zyra Kombëtare e Auditimit njofton se anulohet konkursi i shpallur në dy medie vendore, në faqen zyrtare të internetit dhe në tabelën e shpalljeve të ZKA-së me datën 19.03.2025, për vendin e punës:

I. Pozita: Auditor Junior për auditimin financiar dhe të pajtueshmërisë
Numri i pozitave: Katër (4)
Numri i referencës: AJAFP/ZKA/01-03/25

Konkursi anulohet bazuar në Vendimin Nr. 565 të datës 23.04.2025

Prishtinë, 23.04.2025 Departamenti për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore

OBAVEŠTENJE O OTKAZIVANJU KONKURSA

Nacionalna Kancelarija Revizije obavestava da se otkazuje konkurs objavljen u dva lokalna medija, na zvaničnom sajtu i oglasnoj tabli NKR-a 19.03.2025. godine za radno mesto:

I. Položaj Junior revizor za finansijsku reviziju i reviziju uskladenosti
Broj pozicija: četiri (4)
Broj reference: AJAFP/ZKA/01-03/25

Konkurs se otkazuje na osnovu Odluke br. 565 datuma 23.04.2025.

Priština, 23.04.2025 Departman za upravljanje ljudskih resursa

Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Cjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë

www.facebook.com/gjeipuneshpeite

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Butrint Ahmetaj shpall të pavlefshme diplomën e SH.M. Q.K. Prizren Qendra e Kompetencës.

- Egzon Kuqi shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. Teknike "Nexhmedin Nixha". Gjakovë.

- Fat Zeka shpall të pavlefshme diplomën dhe certifikatën e maturës shtetërore të Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Laureat Bytyqi shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. mjekësisë drejtimi Fizio "Hysni Zajmi" Gjakovë.

- Marie Prenkaj shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12.13 dhe diplomën e sh.m. Mjekësisë "Hysni Zajmi" Gjakovë.

- Dijon Krasniqi shpall te pavlefshme 3 dëftesat dhe diplomën QK "11 Marsi" Prizren.

- Valentin Perdedaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Pjeter Budi " Lubizhde e Hasit.

- Jeton Perdedaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Pheter Budi " Lubizhde e Hasit.

- Sadije Berisha shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IX shfmu " Fadil Hisari " Prizren.

- Venera Qollaku shpall të pavlefshme 4 dëftesat dhe diplomën e shkollës së mesme "Luciano Motroni" Prizren.

- Alnor Boshnjaku shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 dhe diplomën e sh.m. Mjekësisë "Hysni Zajmi" Gjakovë.

- Saime Muhaxhiri B.I. nga Gjakova të numrit fiskal 810246331 të lëshuar nga ARBK.

- Shpresa Krasniqi shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të sh.f.m.u. "Kongresi i Manastirit" Damjan Gjakovë. Nga kl 1-8

- Fatlinda Fazlija shpall të pavlefshme diplomën e gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Resmije Kryeziu shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 1.2.3.4 dhe diplomën e sh.m. Mjekësisë "Hysni Zajmi" Gjakovë.

- Nikë Deda shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 1.2 të Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 400 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)



ROYAL CROWN

RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA
Since 1906

Columbus, Georgia, USA
Since 1906 0.5L

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

